



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.50

Prishtinë, më 27.4.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga MRKS, KDI, OSBE dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës rinisë dhe sportit;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë

Nait Hasani, kryetar, tha se Komisioni në mbledhjen dy mbledhjet e mbajtura më datë 19 dhe 22 prill 2016 ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për Kinematografinë dhe janë bërë disa propozime për ndryshimin e tij, me qëllim që Projektligji të jetë sa më i zbatueshëm në praktikë. Komisioni në këtë mbledhje do të shqyrtojë dhe miratoj amendamentet e propozuara të projektligjit.

Amendamenti 1

Neni 2, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

3. Gjatë kryerjes së veprimtarisë kinematografike, merret parasysh ruajtja e identitetit kulturor të Republikës së Kosovës, në përputhje me parimet e diversitetit kulturor, mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, barazisë gjinore, racës dhe komuniteteve.

Amendamenti 2

Neni 3, riformulohet si vijon:

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Kinematografia** – përfshinë prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen e veprave filmike si veprimtari themelore, si dhe veprimtaritë plotësuese që janë të domosdoshme për ecurinë e kinematografisë.

1.2. **Vepër kinematografike** - vepër audovizuele të çdo metrazhi dhe zhanri të xhiruar në shirit celuloid ose në teknologji digjitale.

1.3. **Producent i filmit** - person fizik apo juridik i cili inicion dhe mbikëqyr procesin e prodhimit të filmit, siguron mjete financiare, merr përgjegjësi për mbarëvajtjen dhe kualitetin e filmit si dhe merr pjesë në promovimin dhe shitjen e filmit.

1.4. **Autor** - personi fizik i cili e ka krijuar veprën.

1.5. **Bashkautor** - personi fizik i cili në bashkëpunim me personin tjetër e ka krijuar veprën e cila përbën tërësi të pandashme.

1.6. **Regjisori debutant** - regjisori i cili realizon për herë të parë film të metrazhit të gjatë.

1.7. **Vepër kinematografike vendore** - filmi në të cilin regjisorin ose producentin janë shtetas të Republikës së Kosovës, ose kompania filmike e regjistruar në Kosovë, ku kontributi i autorëve, artistëve dhe filmbërësve si dhe pjesëmarrja financiare kosovare është mbi 50%.

1.8. **Bashkëprodhimi i veprës kinematografike** – vepra kinematografike e prodhuar nga dy apo më shumë producentë (produksione) që janë subjekt i juridiksionit të vendit ose të huaj, të cilat vepra kinematografike kualifikohen të jenë bashkëprodhim në përputhje me Konventën Evropiane të Kinematografisë dhe të akteve të tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

1.9. **Riprodhimi** - shumëzim në një ose në më shumë kopje të mediumit kinematografik, në shirit celuloidi, teknologji digjitale /DCP/ dhe në formatet e ardhshme teknologjike, në të cilat mund të regjistrohet filmi për vënien në treg, për dhënie në shfrytëzim ose për shfaqje publike.

1.10. **Mediumi** - mbajtësi lëndor i regjistrimit të një veprë filmike, (shiriti celoluid, DCP, video-kaseta, kompakt disku-CD, disku digjital-DVD, Blu Ray dhe formatet e tjera të së ardhmes);

1.11. **Distribuimi** - ndërmarrja e çfarëdo veprimi që lidhet me shpërndarjen e veprës kinematografike për shfrytëzim ose tregtim, përfshirë eksportin dhe importin e saj.

1.12. **Distributori** - personi fizik ose juridik që realizon shërbimet që përkojnë me distribuimin e veprës kinematografike;

1.13. **Shfaqja e veprës Kinematografike** - është projektimi i veprës kinematografike në çfarëdo vendi publik.

1.14. **Shfaqësi** - është personi fizik apo juridik i cili posedon apo merr me qira një hapësirë publike, për shfaqje të veprës kinematografike.

1.15. **QKK** – Qendra e Kinematografisë e Kosovës;

1.16. **AFK** - Arkivi i Filmit të Kosovës;

1.17. **Aktivitetet plotësuese të Kinematografisë** - përfshijnë aktivitetet promovuese, festivalet e filmit, zhvillimin e projekteve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe trajnimet profesionale në lëmin e kinematografisë;

1.18. **Ministria** - nënkupton Ministrinë e Kulturës;

1.19. **Ministër** - nënkupton Ministrin e Kulturës.

Amendamenti 3

Neni 4, riformulohet si vijon:

Veprimtari kinematografike mund të ushtrojë çdo person fizik ose juridik në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

Amendamenti 4

Neni 7 riformulohet si vijon:

1. Për çdo film vendës apo të huaj, që synohet të shfaqet publikisht, para se të ketë shfaqjen e parë në Kosovë, distributori ose shfaqësi, duhet të marrë leje për shfaqjen publike të filmit.
2. Lejen nga paragrafi 1 i këtij neni e jep Komisioni i Vizionimit i QKK-së.
3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk vlen për festivalet e filmit dhe televizionet.
4. Festivalet e filmit dhe televizionit duhet të respektojnë kategorizimin e filmave sipas nenit 8 të këtij Ligji.

Amendamenti 5

Neni 9 paragrafi riformulohet si vijon:

1. Komisioni i Vizionimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
2. Anëtarët e Komisionit të Vizionimit propozohen nga shoqatat e kineastëve dhe shoqëria civile.
3. Anëtarët e Komisionit të Vizionimit zgjedhën nga Këshilli Drejtues i QKK-së nga lista e propozuar me kundër kandidatë.
4. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Vizionimit është katër (4) vjeçar.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Vizionimit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga QKK-ja në përputhje me këtë Ligj.
6. Komisioni i Vizionimit, përbëhet nga pjesëtarë të fushës së kinematografisë dhe të fushave të tjera, si shkrimtarë, sociologë, psikologë, kritikë të filmit, gazetarë, producentë, regjisorë, distributorë dhe shfaqës.
7. Anëtarët e Komisionit të Vizionimit nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune në QKK.

Amendament 6

Neni 10 paragrafi 1 riformulohet si vijon :

1. Nëse shfaqet në publik filmi për të cilin shfaqësi apo distributori nuk ka marr leje sipas nenit 8 të këtij Ligji, atëherë shfaqja e mëtejme ndalohet me vendim nga Komisioni i Vizionimit.

Neni 10, paragrafi 2; 3 dhe 4 fshihen.

Amendamenti 7

Neni 14 riformulohet si vijon:

1. Arkivi i Filmit të Kosovës themelohet si institucion shtetëror për ruajtjen e kontinuitetit dhe vlerave të trashëgimisë kulturore nga lëmi i kinematografisë, në vartësi të Ministrisë së Kulturës.

3. Selia e Arkivit të Filmit të Kosovës është në Prishtinë.

Amendamenti 8

Neni 15, paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti 9

Neni 16 riformulohet si vijon:

1. QKK-ja dhe AFK-ja obligohen të ofrojnë informacionet e kërkuara, kontrollin e dokumentacionit dhe pasqyrat financiare sa herë që këtë e kërkon Ministria e Kulturës.

2. QKK-ja duhet ti paraqes Ministrisë së Kulturës një raport përmbledhës për aktivitetet e zhvilluara në vitin paraprak, realizimin e projekteve kinematografike të përzgjedhura brenda vitit kalendarik, raportet financiare, raportet e promovimit të kinematografisë dhe aktivitetet e tjera plotësuese.

3. AFK-ja duhet t'ia paraqesë një raport përmbledhës Ministrisë së Kulturës, për punën e vet, raportin financiar dhe aktivitetet e tjera përcjellëse për vitin paraprak.

4. QKK-ja dhe AFK-ja raportet e tyre të punës duhet t'i publikojnë në ueb faqet e tyre.

Amendamenti 10

Neni 17 riformulohet si vijon :

Neni 17

Detyrat dhe përgjegjësitë e QKK-së

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e QKK-së janë:

1.1. Nxiti, mbështet dhe subvencionon veprimtarinë kinematografike në funksion të interesit publik.

1.2. Menaxhon buxhetin dhe mbanë përgjegjësi për përdorimin efektiv të tij.

1.3. Ka zotësi juridike për të lidhë kontrata dhe mund të hyj në marrëdhënie detyrimore me personat e tretë sipas legjislacionit në fuqi.

1.4. Bashkëpunon me autoritete publike, me institucione, organizata dhe asociacione vendore e të huaja, në të gjitha çështjet me interes për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillimin e kinematografisë dhe shkëmbimin e përvojave e të informacioneve.

1.5. Bashkëpunon me autoritete homologe të vendeve të tjera, aderon në organizatat dhe asociacionet rajonale e ndërkombëtare nga fusha e kinematografisë, si dhe merr pjesë në aktivitetet e tyre.

1.6. Licencon produksionet Kinematografike sipas kriterëve të regjistrimit të përcaktuara me akt nënligjor.

1.7. Krijon dhe përditëson bazën e të dhënave në lidhje me krijimtarinë filmike vendore dhe botërore, për subjektet që merren me kinematografi në Kosovë, për ecuritë në tregun e veprave filmike, për koston e prodhimit, për trendët më të reja në krijimtarinë e teknologjinë filmike si dhe i vë në dispozicion informacionet e nevojshme për subjektet e interesuara.

1.8. Funksionon në mënyrë profesionale e të pavarur duke respektuar parimin e transparencës dhe të mosdiskriminimit.

Amendamenti 11

Neni 20, riformulohet si vijon:

1. Këshilli Drejtues përbëhet prej pesë (5) anëtarëve të cilët i emëron Ministri për Kulturë sipas nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni:

1.1 Katër (4) anëtarë të Këshillit Drejtues propozohen nga shoqatat e kineasëve profesionist të Kosovës me listë me kundër kandidatë,

1.2. Një (1) anëtarë i Këshillit Drejtues delegohet nga Ministri i Kulturës.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është tre (3) vjeçar.

3. Këshilli Drejtues përbëhet nga personalitete të shquara të fushës së kinematografisë, si: regjisorë, producentë, aktorë, skenaristë, montazherë, drejtorë fotografie, kompozitorë dhe kineastë të tjerë. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të kenë arsimim universitar nga lëmi i Kinematografisë, ose të kenë një film të metrazhit të gjatë në cilësinë e autorit, producentit ose protagonistit.

4. Shoqatat profesioniste të cilat kanë të drejtën e delegimit të kandidatëve për Këshillin Drejtues, duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi që dëshmojnë se në radhët e veta kanë me shumë se tridhjetë (30) anëtarë me arsimim universitar nga lëmi i kinematografisë.

5. Nuk mund të emërohet apo të mbetet anëtar i Këshillit Drejtues personi që:

5.1. mbanë a vihet në post publik të zgjedhur;

5.2. është a bëhet anëtarë i organit ekzekutiv të një partie politike;

5.3. në tre (3) vitet e fundit është i dënuar për vepër penale;

5.4. është anëtarë në një këshilli drejtues të një institucioni tjetër të kulturës.

6. Anëtarët e Këshillit Drejtues në mbledhjen e parë konstituive zgjedhin nga radhët e veta kryesuesin me mandat tre (3) vjeçar.

7. Këshilli Drejtues vendos me shumicën e votave të anëtarëve.

8. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune në QKK.

9. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të jenë anëtarë të Jurisë Vlerësuese.

Amendamenti 12

Neni 21 riformulohet si vijon:

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues janë:

1.1. Mbikëqyr punën e QKK-së;

1.2. Aprovon politikat dhe strategjitë e zhvillimit të QKK-së;

1.3. Me propozim të drejtorit miraton planin vjetor buxhetor të QKK-së;

1.4. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar të QKK-së;

1.5. Harton dhe propozon Statutin e QKK-së dhe rregulloren për punën e vet të cilat i miraton Ministri;

1.6. Harton dhe miraton rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore të QKK-së;

1.7. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e QKK-së;

1.8. Cakton përbërjen e të gjitha komisioneve të QKK-së me propozim të drejtorit;

1.9. Në bazë të vendimit të Jurisë Vlerësuese, miraton projektet për subvencionim dhe cakton kuotën e subvencionimit;

1.10. Përcakton programin vjetor të aktiviteteve dhe masat për realizimin e tij, ndjek dhe vlerëson ecuritë e realizimit të programit.

Amendamenti 13

Neni 22 riformulohet si vijon:

1. Drejtori i QKK-së zgjedhet dhe shkarkohet nga Këshilli Drejtues.

2. Drejtori i QKK-së zgjedhet me konkurs publik.

3. Mandati i Drejtorit të QKK-së është katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

4. Drejtori i QKK-së duhet të ketë arsimim universitar dhe së paku pesë (5) vite përvojë menaxheriale nga lëmi i kinematografisë

Amendamenti 14

Neni 23, nënparagrafi 1.1; 1.6 dhe 1.7 riformulohen si vijon:

1.1. Bën menaxhimin financiar dhe administrativ të QKK-së;

1.6. Aplikon dhe është përgjegjës për marrjen e donacioneve;

1.7. Mbikëqyr të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe të donacioneve;

Amendamenti 15

Neni 26, në nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 pas fjalës ”**subvencionohen**” fshihen fjalët:”**në masë**”.

Amendamenti 16

Neni 27 paragrafi 1 dhe 6 riformulohen si vijon :

1. Këshilli Drejtues i QKK-së në përputhje me programin e aktiviteteve dhe mundësitë buxhetor çdo vit shpall konkurse për projekte filmike.

6. Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Amendamenti 17

Neni 28 riformulohet si vijon:

1. Juria vlerësuese bën vlerësimin dhe përzgjedh për miratim projektet filmike.

2. Jurinë për filma të metrazhit të gjatë e emëron Këshilli Drejtues i QKK-së nga lista me kundër kandidat të propozuar nga drejtori i QKK-së.

3. Jurinë për filma të metrazhit të shkurtër, dokumentar dhe të animuar e emëron Këshilli Drejtues i QKK-së nga lista me kundër kandidat të propozuar nga drejtori i QKK-së.

4. Juria emërohet më së largu tridhjetë (30) ditë pas mbylljes së konkursit.

5. Juria vlerësuese për filmin e metrazhit të gjatë, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve të cilët nga radhët e veta zgjedhin me shumicë votash, kryesuesin që në mbledhjen e parë.

6. Juria vlerësuese për filmin e metrazhit të shkurtër, dokumentar dhe të animuar përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët nga radhët e veta, zgjedhin me shumicë votash kryesuesin që në mbledhjen e parë.

7. Për anëtarë të jurisë vlerësuese për film të metrazhit të gjatë emërohen kineastë me arsimim universitar nga lëmi i kinematografisë ose kineastë që kanë të realizuar të paktën një film artistik të metrazhit të gjatë, në cilësinë e autorit apo të protagonistit.

8. Për anëtarë të Jurisë Vlerësuese për film të metrazhit të shkurtër, dokumentar dhe të animuar emërohen kineastë me arsimim universitar nga lëmi i kinematografisë ose kineastë që kanë të realizuar të paktën një film artistik të metrazhit të shkurtër, në cilësinë e autorit apo të protagonistit.

9. Anëtar i Jurisë Vlerësuese nuk mund të emërohet personi që është:

9.1. në lidhje të afërt familjare ose bashkëshortore me drejtorin e QKK-së, apo me ndonjërin nga anëtarët e Këshillit Drejtues;

9.2. në lidhje të afërt familjare ose bashkëshortore me paraqitësin e projektit konkurrues, me autorin e skenarit ose të veprës letrare të përshtatur për skenar;

9.3. që ka interes financiar të drejtpërdrejtë (partneritet) ose të tërthortë (bashkëthemelues ose aksionar) ose punonjës në biznesin e paraqitësit të projektit filmik;

9.4. që ka projekte të pa përfunduara me QKK-në.

10. Anëtarët e Jurisë Vlerësuese paraprakisht njoftohen me pengesat për të qenë apo për të mbetur anëtarë të Jurisë, si dhe me të dhënat për identitetin e paraqitësve të projekteve konkurruese dhe autorët e tyre.

11. Secili anëtar i Jurisë Vlerësuese nënshkruan deklaratë nën betim se nuk ka asnjë pengesë për të qenë anëtar i Jurisë.

12. Anëtarët e Jurisë Vlerësuese duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.

Amendamenti 18

Neni 30, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Komisioni Financiar propozohet nga drejtori i QKK-së dhe miratohet nga Këshilli Drejtues pas mbylljes së konkursit për projekte filmike.

Amendamenti 19

Neni 31 riformulohet si vijon :

1. Këshilli Drejtues vendos për subvencionimin e projekteve filmike përfshirë edhe shumën e subvencionit në bazë të përzgjedhjes nga Juria Vlerësuese dhe mbështetur në raportin e Komisionit Financiar.

2. Në rast se Këshilli Drejtues gjatë vendimmarrjes konstaton shkelje ligjore, e kthen në rivlerësim propozimin e Jurisë Vlerësuese apo raportin e Komisionit Financiar.

Amendament 20

Neni 32, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

3. Këshilli Drejtues tërheq vendimin për subvencionimin e projektit nëse konstaton se producenti fitues ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni.

Amendamenti 21

Neni 34 paragrafi 1 dhe 2 riformulohen si vijon:

1. Pjesëmarrësi në konkurs, projekti i të cilit është refuzuar, brenda pesë (5) ditësh mund të kërkojë nga QKK-ja rishikimin e vendimit nëse:

1.1. projekti i tij nuk është shqyrtuar fare nga juria;

1.2. projekti i tij ka qenë i përzgjedhur nga Juria Vlerësuese dhe vendimi i saj nuk është përfillur;

1.3. ka në dispozicion të dhëna apo prova se ndonjëri anëtar i jurisë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 të këtij ligji.

2. Kërkesa për rishqyrtim do të aprovohet nëse pretendimet e ankuesit rezultojnë të vërteta, përkatësisht do të refuzohet, nëse rezultojnë të pabaza. Kërkesa për rishikim që kundërshton vendimin e Jurisë Vlerësuese, në aspektin artistik, hidhet poshtë.

Amendamenti 22

Neni 35 riformulohet si vijon :

Paraqitësi i projektit filmik, njoftohet me shkrim me vendimin e Këshillit Drejtues për miratimin apo refuzimin e projektit filmik. Njoftimi për miratimin e projektit fitues, me të dhënat identifikuese për paraqitësin e tij dhe për përbërjen e Jurisë Vlerësuese, publikohet në ueb faqen e QKK-së.

Amendamenti 23

Neni 37 fshihet.

Amendamenti 24

Neni 38, nënparagrafi 1.8 dhe 1.9 fshihen.

Amendamenti 25

Neni 39 riformulohet si vijon:

Neni 39

Afati për realizimin e projektit

1. Afati për fillimin e xhirimit të veprës filmike është një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

2. Kohëzgjatja e realizimit të projektit që rezulton me kopjen e parë të filmit, nuk mund të jetë më e gjatë se dy (2) vite nga data e lidhjes së kontratës.

3. Me vendim të Këshillit Drejtues, afati për realizimin e projektit mund të shtyhet edhe për dy (2) vite, në rast se vepra Kinematografike ka specifika të veçanta

4. Nëse producenti nuk arrin të fillojë xhirimet sipas afatit të paraparë në paragrafin 1 të

këtij neni dhe të realizojë projektin sipas paragrafit 2 të këtij neni, i njëjti e humbë të drejtën e subvencionimit të projektit dhe obligohet që mjetet e marra t'ia kthej QKK-së.

Amendamenti 26

Neni 40, nënparagrafi 1.5 fjala **”qenësisht”** zëvendësohet me fjalën **”rrënjësisht”**.

Amendament 27

Neni 41 riformulohet si vijon:

Shtëpia prodhuese, producenti, autori, skenaristi apo regjisori për shkak të të cilit ka dështuar realizimi i projektit nuk ka të drejtë të konkurrojë në QKK me të njëjtin projekt e as me ndonjë projekt tjetër për pesë (5) vitet e ardhshme.

Amendamenti 28

Neni 42 riformulohet si vijon:

Arkivi i Filmit i Kosovës është institucion profesional që merret me mbledhjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kinematografike.

Amendamenti 29

Neni 43 riformulohet si vijon:

Arkivi i Filmit të Kosovës ka bibliotekën e veçantë me koleksione që përmbajnë literaturë nga kritika, teoria dhe historia e artit filmik, kopje skenarësh të filmit dhe botime profesionale lidhur me regjinë, xhirimin, animacionin, montazhin, komunikimet audiovizuele etj, si dhe muzeun filmik me aparatura, sende e materiale me vlerë historike e shkencore për krijimtarinë kinematografike.

Amendamenti 30

Neni 44, paragrafi 5 fshihet teksti : **”referativ e”**

Neni 44 paragrafi 7 fshihet teksti si vijon: **” (në hapësirat e AFK-së),”**

Neni 44 paragrafi 8 riformulohet si vijon:

8. Materiali burimor si negativi, mediumi digjital, videogrami i pamjeve dhe i zërit të veprës filmike, lejohet të përdoret, duke përfshirë përdorimin edhe jashtë Kosovës, me kërkesë të producentit të veprës filmike si pronë e patjetërsueshme e tij. Ky material duhet t'i kthehet AFK-së në gjendje të pandryshuar, brenda një (1) viti.

Amendamenti 31

Neni 45, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Producenti vendës i një vepre filmike, brenda një (1) viti nga data e shfaqjes publike, obligohet që Arkivit të Filmit të Kosovës, t'ia dorëzojë një kopje të papërdorur të veprës filmike.

Amendamenti 32

Neni 46 paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Arkivi i Filmit i Kosovës udhëhiqet nga Drejtori, i cili zgjedhet përmes konkursit publik nga Ministria e Kulturës, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Amendamenti 33

Neni 47 riformulohet si vijon:

Neni 47

Financimi i Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Arkivit të Filmit të Kosovës

1. Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Arkivi i Filmit të Kosovës kanë kod të veçantë buxhetor brenda buxhetit të Ministrisë së Kulturës.

2. Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Arkivi i Filmit të Kosovës financohen nga:

1.1. Buxheti i Kosovës;

1.2. Donacionet;

1.3. Të hyrat vetanake.

Amendamenti 34

Neni 48 riformulohet si vijon:

Kinematë në pronësi shoqërore ose publike, të privatizuara apo të dhëna me qira personave fizik ose juridik, nuk mund t'iu ndryshohet qëllimi i veprimtarisë apo destinimi.

Amendamenti 35

Neni 49 riformulohet si vijon:

1. Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, përpilon skemën për lehtësira financiare për prodhuesit e filmit, si dhe një sistem mbështetës për shfaqësit dhe distributorët.

2. Skema për lehtësime financiare rregullohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.

Amendamenti 36

Neni 51 riformulohet si vijon:

1. Me gjobë prej njëzetmijë euro (20.000) deri në dyzetmijë euro (40.000), gjobitet për kundërvajtje :

1.1. Personi fizik apo juridik që censuron prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen publike të veprave filmike, siç është përcaktuar në nenin 5 të këtij Ligji.

1.2. Personi juridik nëse jep leje për filmat që nxisin urrejtje etnike, racore, religjioze, terrorizmin dhe aktivitete tjera kriminale, siç është përcaktuar në nenin 8 të këtij Ligji.

1.3. Personi fizik apo juridik që një kinemaje ia ndryshon qëllimin e veprimtarisë së Kinemasë, siç është përcaktuar në nenin 48 të këtij Ligji.

2. Me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në njëzetmijë euro (20.000) gjobitet për kundërvajtje :

2.1. Personi fizik dhe juridik i cili xhiron pa lejen e organit kompetent, siç është përcaktuar në nenin 6 të këtij Ligji.

2.2. Personi fizik dhe juridik që shfaqë një film të pa pajisur me lejen për shfaqje publike ose që i është refuzuar dhënia e lejes, siç është përcaktuar në nenin 7 dhe 8 të këtij Ligji.

2.3. Personi juridik që lejon të miturit të kenë qasje në kinema, ose të shfaq film kur përmbajtja e veprave filmike është e papërshtatshme për moshën e tyre, siç është përcaktuar në nenin 8 të këtij Ligji.

2.4. Personi Juridik për shfaqje të filmit, siç është përcaktuar në nenin 8 të këtij Ligji.

2.5. Personi fizik dhe juridik i cili bën shpërndarjen, shitjen dhe dhënien me qera të filmave, siç është përcaktuar në nenin 11 të këtij Ligji.

3. Me gjobë prej pesëqind euro (500) deri në pesëmijë euro (5.000) gjobitet për kundërvajtje:

3.1. Personi fizik apo juridik që pengon producentin e filmit të xhirojë skena filmike në vende publike që nuk janë të kufizuara për xhirim, siç është përcaktuar në nenin 6 të këtij Ligji.

3.2. Anëtar i Këshillit Drejtues që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues, siç është përcaktuar në nenin 20 të këtij Ligji.

3.3. Anëtar i Jurisë që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i jurisë vlerësuese ose që ka marrë pjesë në mbledhjet e Jurisë vlerësuese, siç është përcaktuar në nenin 28 të këtij Ligji.

3.4. Shtëpitë filmike prodhuese të filmit vendor të cilat nuk ia dorëzojnë Arkivit të filmit një kopje të filmit dhe materialet tjera në dispozicion brenda një (1) viti nga dita e mbajtjes së premierës, siç është përcaktuar në nenin 45 të këtij Ligji.

4. Të gjitha gjobat e shqiptuara për kundërvajtje nga fushëveprimtaria e kinematografisë, derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Amendamenti 37

Neni 52 riformulohet si vijon:

1. Kosova Filmi pushon së funksionuari me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Arkivi dhe prona intelektuale e Kosova Filmit kalon në menaxhim të Arkivit të Filmit të Kosovës.

3. Prona e paluajtshme (toka dhe objektet përcjellëse) e Kosova Filmit kalon në pronësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Punëtorët e Kosova Filmit sistemohen në Arkivin e Filmit të Kosovës.

Amendament 38

Pas nenit 52 shtohet nen i ri si vijon:

Aktet nënligjore

Ministria brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji.

Anëtarët e Komisionit votuan dhe miratuan amendamentet e propozuara me shumicë votash.

Anëtarja e Komisionit Mufera Sinik votoi kundër amendamentit nr 11 që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Drejtues, me kërkesë që me rastin e përzgjedhjes së Këshillit të respektohet parimi i barazisë gjinore dhe etnike.

Ajo gjithashtu votoi kundër amendamentetev të Projektligjit në përgjithësi.

Raporti me amendamente i procedohet Komisioneve të përhershme për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani tha se Projektligji për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është shqyrtuar dhe miratuar në parim në mbledhjen e mbajtur më 9 Shkurt 2016, ndërsa Dëgjimi Publik lidhur me këtë Projektligj është mbajtur më 13.4.2016.

Me anë të këtij Projektligji parashihet të rregullohen kushtet dhe mënyra e sponsorizimeve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Bekim Haxhiu propozoi që nga teksti dhe titulli i Projektligjit të fshihet teksti i donacioneve duke marrë parasysh se çështja e donacioneve nuk do duhej të trajtohet në këtë Projektligj, ngase fusha e donacioneve rregullohet me dispozita tjera ligjore.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët tjerë të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin nen për nen të Projektligjit dhe u propozuan këto:

Amendamenti 1

Titulli i Projektligjit fshihen fjalët: ‘dhe donacione’ ky ndryshim vlenë për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 2

Fshihet teksti si vijon: “DISPOZITAT E PËRGJITHSHME”.

Amendamenti 3

Neni 1

Paragrafi 2; 3 dhe 4 barten te neni 2 te fushëveprimi.

Amendamenti 4

Neni 2

Paragrafi 1.2. fshihet.

Anëtarët e Komisionit, vijojnë me shqyrtimin e Projektligjit për Sponsorizime në mbledhjen e radhës.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani